

NDËRMJETËSIMI MES BASHKËMOSHATARËVE

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Programi “Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve” ka dal si rezultat i punës disavjeçare që është bërë në kuadër të projekteve për parandalimin e dhunës në shkolla. Më konkretisht, në vitin 2013, kur është hartuar dhe aprovuar “Rregullorja QRK 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar” që është inicuar nga projekti “Parandalimi i dhunës në shkolla” të zbatuar nga KEC dhe përkrahur nga UNICEF, në nenin 9, pika 1.8 inkurajon shkollat që të themelojnë dhe funksionalizojnë ekipet e ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve. Që nga viti 2015 është punuar në finalizimin e programit të trajnimit të bazuar në përvojat dhe praktikat më të mira nga shkollat e Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:

- Të kuptojnë çfarë është konflikti, cilat janë llojet e konfliktit, natyra e konflikteve në shkolla
- Të kuptojnë rëndësinë e komunikimit në zgjidhjen e konflikteve
- Të përvetësojnë teknika dhe metoda për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve
- Të jenë të gatshëm për të zhvilluar seanca ndërmjetësimi
- Të jenë të gatshëm për të shpërndarë dijet dhe informacionet edhe tek palët e treta

Përmbajtja:

Ndërmjetësimi është një proces i strukturuar në të cilën një palë e tretë neutrale u ndihmon njerëzve ose grupeve të përfshira në një mosmarrëveshje për të komunikuar dhe për të zgjidhur konfliktin. Qëllimi i ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve është që të zgjidhin konfliktet në mënyrë jo të dhunshme dhe të qëndrueshme. Është një proces vullnetar me hapa dhe praktika të përcaktuara që udhëheqin një palë të tretë të paanshme, ndërmjetësuesin, në sjelljen e tij ose të saj. Në kontekstin shkollor, studentët dhe mësuesit veprojnë si ndërmjetës për të zgjidhur konfliktet midis nxënësve, por edhe mes tyre dhe mësuesve, drejtorëve dhe prindërve. Por, përtej të qenit vetëm një proces teknik, ndërmjetësimi nxit një frymë të caktuar duke u bazuar në vlerat kryesore të saj. Si rezultat, efekti i ndërmjetësimit shpesh është më i madh se thjesht zgjidhja e konflikteve. Në kontekstin e shkollës raportohet rregullisht se atmosfera e shkollës ndryshon pozitivisht kur prezantohet ndërmjetësimi: drejt

një fryme më bashkëpunuese dhe optimiste, duke u mundësuar studentëve, mësuesve dhe prindërve të ndjejnë pronësinë e shkollës si një e tërë.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet nxënësve, mësimeve, psikologëve shkollor, pedagogëve, udhëheqësve të shkollave dhe të personave të tjerë që merren me zgjidhje të konflikteve (përfaqësues të QPS, PK, OShC)

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi organizohet përmes sesioneve trajnuese që zgjasin 2 ditë trajnimi dhe 1 ditë praktikë. Gjatë dy ditëve të para ofrohet e gjithë përmbajtja e trajnimit, ndërsa dita e tretë zhvillohet me bazë në shkollë, ku pjesëmarrësit duhet të përmbushin disa detyra specifike, më konkretisht, duhet të zbatojnë në praktikë teknikat, metodat dhe shkathtësitë e fituara gjatë trajnimit. Numri i pjesëmarrësve në trajnim 25-30.

Vlerësimi/Certifikimi

Të gjithë pjesëmarrësit do të simulojnë seanca ndërmjetësimi. Trajnerët do të vlerësojnë pjesëmarrësit në bazë të performancës gjatë seancave simuluese. Vetëm kandidatët që kalojnë 50% e arritshmërisë dhe që nuk mungojnë në sesionet trajnuese certifikohen.

Materialet e trajnimit

1. Doracak për ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve, KEC/UNICEF, Maj 2016
2. Hyrje në ndërmjetësimin mes bashkëmoshatarëve, forumZFD, OSCE, Shtator 2014
3. Udhëzues për trajnerë, KEC/forumZFD, Maj 2017
4. Materiale të tjera (fletëshpërndarëse, prezantime, video –materiale)